

HAMZA: JAM I GATSHËM TA MARR PËRGJEGJËSINË PËR KRIJIMIN E QEVERISË SË RE

FAQE 4-5

Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, pas certifikimit të zgjedhjeve të 9 shkurtit nga KQZ-ja, ka thënë se është i gatshëm ta formojë qeverinë re nëse një gjë të tillë dështon ta bëjë Vetëvendosja.

Hamza ka thënë se Kosova nuk e ka komoditetin të ketë vakum institucional. Ai ka përsëritur qëndrimin e edhe gjatë fushatës zgjedhore se nuk ka vija të kuqe për asnjë parti dhe është i gatshëm të bisedojë me të gjithë. Pavarësisht prej kësaj, Hamza ka thënë se qeverinë është i gatshëm ta bëjë me partitë e deritashme opozitare me përfaqësuesit e të cilave ka bërë me dije se është në komunikim

BEGAJ: SHPRESOJMË NË MBËSHTETJEN E SLOVAKISË PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

F.3



OPINION

NGUSHËLLIMI PËRMES SYVE

F.8

Shkruan: Ismail SYLA

AKTUALE

PËRKUJTOHEN 147 CIVILËT SHOIPTARË TË VRARË NGA FORCAT SERBE NË IZBICË

F.7

MOSMARRËVESHJE TË VAZHDUESHME NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË PËR VIZITAT ZYRTARE

F.3

BERAT LAHU DHE EDMOND AZEMI PËRJASHTOEN NGA VETËVENDOSJA

F.7

EKONOMI

PASTRIMI I PARAVE DËMTON BUXHETIN E SHTETIT, MINON SISTEMIN EKONOMIK

F.8

KOMPANITË EKSPORTUESE GJERMANE, PARA KOHËSH TË VËSHTIRA

F.8

SPORT

DUELE VENDIMTARE NË SUPERLIGË

F.10

RENOVA

PUTZ

Magedoni
Xhepcisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princesha-ks.com

044/256-051
044/367-061
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji
BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Macroni shtyn përpara planet për një forcë sigurie në Ukrainë gjatë samitit në Paris

PARIS, 28 MARS - Liderë nga më shumë se 30 vende janë takuar në Paris për të biseduar për gjetjen e një mënyre se si ta forcojnë pozicionin e Ukrainës brenda dhe jashtë fushëbetejës. Ata premtuan ndihmë të re për Kievin dhe shqyrtuan propozimet për vendosjen e forcave evropiane në Ukrainë në rast të ndonjë marrëveshje për paqe.

Pas samitit të quajtur “koalicioni i vullnetit”, i cili nuk përfshinë Shtetet e Bashkuara, presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka thënë se liderët e mbledhur në Paris janë më të bashkuar se kurrë rreth Ukrainës dhe se ata duhet të garantojnë se janë në gjendje ta kundërshtojnë synimin e Rusisë për zvarritjen e bisedimeve për paqe me qëllim të marrjes së më shumë territor.

“Qëllimi ynë është i qartë. Është të arrijmë paqe dhe për ta bërë këtë, duhet ta vendosim Ukrainën në pozicionin më të mirë të mundshëm”, ka thënë Macroni në një konferencë për medie pas samitit.

Presidenti francez ka thënë se ministrat e jashtëm të vendeve anëtare të koalicionit kanë për detyrë shqyrtimin e çështjeve specifike ligjore mbi çdo forcë sigurie të udhëhequr nga Evropa, për ta mbështetur një armëpushim, dhe do të raportojnë përsëri brenda tri javësh.

“Do të ketë një forcë sigurie që do të veprojë në Ukrainë, duke përfaqësuar disa vende. Nuk është Rusia ajo që mund të vendosë nëse një forcë sigurie mund të vendoset në Ukrainë”, ka këmbëngulur Macroni.

Ai ka theksuar se tani për tani nuk ka njëzëshmëri për dërgimin e një force të udhëhequr nga Evropa dhe se jo të gjithë anëtarët janë

pajtuar të marrin pjesë, megjithëse theksoi se kjo nuk është e nevojshme për të ecur përpara.

Duke folur një ditë para samitit me presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelensky, Macroni ka hënë se kjo forcë sigurie nuk do të dërgohej në vijën e parë të luftës dhe nuk do të kishte për detyrë mbikëqyrjen apo zbatimin e ndonjë armëpushimi.

Sipas tij, një detyrë e tillë mund t’u caktohet paqeruajtësve të OKB-së.

Gjatë konferencës së tij për medie, Macroni ka theksuar se disa vende pjesëmarrëse dhanë zotime të reja për ndihmë ndaj Ukrainës, përfshirë njoftimin e Francës për një paketë të re ndihmë ushtarake me vlerë dy miliardë euro.

Macroni ka thënë se liderët evropianë u pajtuan të mos i lehtësojnë sanksionet e vendosura ndaj Rusisë dhe se ata do të ndërmarrin masa shtesë për ta goditur të ashtuquajturën flota e errët e Rusisë.

Ritheksimi i mbështetjes për Ukrainën

Përtej këtyre propozimeve, liderët diskutuan se si mund t’i koordinonin çështjet aktuale që po trajtohen në negociatat e udhëhequra nga ShBA-ja me Moskën dhe Kievin, duke përfshirë një kërkesë të debatueshme të Rusisë për t’i lehtësuar sanksionet para se të zbatohet një armëpushim. Më herët këtë javë, disa raunde bisedimesh të koordinuara nga ShBA-ja me Kievin dhe Moskën në Arabinë Saudite çuan në njoftimin e një marrëveshjeje që, sipas Shtëpisë së Bardhë, rezultoi në një zotim “për të zhvilluar masa për zbatimin” e



premtimeve të fundit për t’i ndaluar sulmet ndaj objekteve energjetike dhe për një armëpushim në Detin e Zi.

Por, Rusia është duke kërkuar të plotësohen një sërë kushtesh, përfshirë lehtësimin e sanksioneve, në këmbim të respektimit të marrëveshjes.

Duke folur një ditë para samitit, së bashku me presidentin Zelensky, i cili gjithashtu ka marrë pjesë në samit, Macroni ka akuzuar Rusinë për shfaqjen e një “dëshire për luftë” dhe ka ngulur këmbë se Moska duhet ta pranojë armëpushimin 30-ditor “pa kushte paraprake”.

Mes një vale diplomacie të rëndësishme të udhëhequr nga ShBA-ja për t’i dhënë fund luftës në Ukrainë, liderët evropianë janë përpjekur ta sigurojnë një vend në tryezën e bisedimeve, por deri më tani janë përjashtuar nga raundet e bisedimeve mes Moskës, Kievit dhe Uashingtonit.

I nxitur nga marrëveshja e fundit për Detin e Zi dhe këmbëngulësia e Rusisë që të fillojë lehtësimi i sanksioneve si pjesë e procesit, samiti në Paris u përqendrua gjithashtu në çështjen e heqjes së kufizimeve financiare.

Pas samitit, Macroni ka thënë se ai dhe liderët e tjerë u pajtuan se tani nuk është koha për t’i hequr sanksionet e vendosura ndaj Rusisë pas pushtimit të saj të plotë të Ukrainës në vitin 2022.

Zyrtarët amerikanë kanë ngritur së fundmi mundësinë e lehtësimit të disa sanksioneve të tyre ndaj Rusisë.

Duke folur për gazetarët gjatë një vizite pune në Xhamajkë, sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, ka thënë se Uashingtoni do t’i shqyrtojë kushtet e Moskës. “Ne do ta vlerësojmë këtë. Disa nga këto kushte përfshijnë sanksione që nuk janë tonat – ato i përkasin Bashkimit Evropian”, ka thënë

Rubio në një konferencë për medie në Xhamajkë më 26 mars. Sekretari amerikan i Thesarit, Scott Bessent, ka thënë në një intervistë për “Fox News” më 26 mars se beson që Trumpi “nuk do të hezitojë t’i rrisë sanksionet, nëse kjo i jep përparësi atij në bisedime”.

Ai ka theksuar se shtrëngimi ose lehtësimi i sanksioneve do të varet nga veprimet e mëtejshme të udhëheqjes ruse. Bessent ka thënë se Shtetet e Bashkuara dhe Ukraina mund të nënshkruajnë marrëveshje për burimet natyrore javën e ardhshme.

Marrëveshja fillimisht ishte planifikuar të nënshkruhej më 28 shkurt gjatë vizitës së fundit të Zelenskyt në Uashington, por ceremonia e nënshkrimit ishte shtyrë pas një debati të ashpër midis Zelenskyt, Trumpit dhe nënpresidentit JD Vance në Zyrën Ovale.

Një tërmet i fuqishëm godet Azinë Juglindore

BANGKOK, 28 MARS - Një tërmet i fuqishëm ka goditur Azinë Juglindore, duke mbytur disa persona. Dridhjet e fuqishme të tokës kanë shkakuar shembjen e objekteve në ndërtim e sipër në Bangkok dhe shkatërruar ndërtesa e ura në Mianmar, ku junta ushtarake ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme në disa zona.

Të paktën tre persona janë mbytur në Tuango të Mianmarit - që njihej më herët si Burma - pasi një xhami është shembur pjesërisht, kanë thënë dëshmitarët, ndërsa mediet lokale kanë raportuar se dy persona janë mbytur dhe 20 të tjerë janë lënduar pas shembjes të një hoteli në Aung Ban.

Në Tajlandë, guvernatori i Bangkokut, Chadchart

Sittipunt, ka thënë se janë tri viktima nga tërmeti. Ai paralajmëroi se mund të jetë pasgoditje, por u ka bërë thirrje njerëzve që të ruajnë qetësinë, duke shtuar se situata gjerësisht ishte nën kontroll. Të paktën një person është mbytur dhe dhjetëra punëtorë janë nxjerrë nga rrënojat e një rrokaqielli, ka thënë Instituti Kombëtar për Emergjenca Mjekësore në Tajlandë.

Dëshmitarët në Bangkok kanë thënë se njerëzit dolën në rrugë në panik pas dridhjeve të fuqishme të tokës. Shërbimi Gjeologjik i Shteteve të Bashkuara, ka thënë se tërmeti ishte 7.7 ballë i Rihterit, me një thellësi prej 10 kilometrash.

Epiqendra e tërmetit ishte 17.2 kilometra nga qyteti Mandalaj



në Mianmar, qytet që ka një popullsi prej 1.5 milion banorësh. Pas tërmetit të fuqishëm, kishte edhe disa dridhje të fuqishme të tokës, por edhe me intensitet më të

ulët. Në Mianmar, tërmeti ka shembur ndërtesa në pesë qytete, por edhe një rrugë dhe një urë në Jangon, qytetit më të madh në vend.

Ushtria në Mianmar, që udhëheq me shtetin, ka shpallur gjendje emergjente në disa rajone.

Junta ka marrë pushtetin më 2021 përmes grushtit të shtetit, që ka çuar në luftë civile, dhe që atëherë udhëheqja ushtarake është izoluar ndërkombëtarisht. Në mediet sociale janë publikuar pamje nga Mandalaja e Mianmarit, duke shfaqur shembje të ndërtesave, përfshirë të një pjese të Pallatit Mandalaj.

Agjencia “Xinhua” e Kinës ka raportuar e dridhje të fuqishme të tokës janë ndier në provincën Junan, në jugperëndim të Kinës, që gjendet në kufi me Mianmarin. Por, autoritetet kineze nuk kanë raportuar për viktima.

MOSMARRËVESHJE TË VAZHDUESHME NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË PËR VIZITAT ZYRTARE

PRISHTINË, 28 MARS - Zyrtarët e Kosovës dhe të Serbisë do të bëjnë vizita të ndërsjella për ta çuar përpara procesin e normalizimit të marrëdhënieve, ose për t'i kontribuar dialogut që ndërmjetëson Bashkimi Evropian për këtë qëllim. Kështu, së paku, thuhet në Marrëveshjen për vizitat zyrtare që Prishtina dhe Beogradi kanë arritur në vitin 2014. Por, përkundër saj, palët ua ndalojnë shpesh vizitat zyrtareve të njëra-tjetrës, duke i akuzuar për mosrespektim të procedurave.

Më 26 mars Kosova ia ka ndaluar vizitën ministrit serb të Shëndetësisë, Zllatibor Llonçar, ndërsa më 20 mars Serbia ia ndaloi vizitën ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku.

Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës e ka shpjeguar vendimin e saj, duke thënë se Prishtina fillimisht i ka dërguar një kërkesë për vizitë Beogradit, së cilës ai nuk iu është përgjigjur, duke theksuar se qasja e Kosovës ndaj vizitave zyrtare do të mbetet e bazuar në reciprocitet.

Nga Serbia nuk është dhënë ndonjë shpjegim se përse është refuzuar kërkesa e Çekut, por Kosova është akuzuar për "minim të drejtpërdrejtë të normalizimit të marrëdhënieve".

"Radio Evropa e Lirë" ka kërkuar nga Bashkimi Evropian t'i komentojë ndalesat e fundit të vizitave të zyrtarëve nga Kosova dhe Serbia, përkatësisht ta vlerësojë dëmin që veprimet e tilla i shkaktojnë procesit që synon normalizimin e marrëdhënieve, por nuk ka marrë përgjigje. BE-ja, më herët, ka deklaruar se pret të respektohen të gjitha marrëveshjet e arritura, përfshirë edhe atë për vizitat zyrtare.

Çfarë thotë marrëveshja për vizitat zyrtare?

Në marrëveshjen e vitit 2014 për vizitat zyrtare thuhet se palët - nëpërmjet oficerëve ndërlidhës - do ta informojnë njëra-tjetrën për vizitat e



zyrtarëve të tyre të kategorisë së parë dhe të dytë.

Kategoria e parë përfshin: presidentin, kryeministrin, zëvendëskryeministrat, kryetarin e Kuvendit dhe ministrat e Brendshëm, të Jashtëm dhe të Mbrojtjes. Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë të gjithë ministrat e tjerë, nënkryetarët e Kuvendit, drejtorët e zyrave qeveritare dhe të agjencive të sigurimit, kryetarët e Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të lartë, prokurori publik, si dhe të gjithë personat e tjerë që kanë siguri fizike, si udhëheqësit fetarë.

Për vizitat e zyrtarëve që bëjnë pjesë në kategorinë e parë, kërkesa duhet të bëhet së paku 72 orë përpara, ndërsa për vizitat e zyrtarëve të kategorisë së dytë, pala tjetër duhet të njoftohet së paku 48 orë përpara. Oficeri ndërlidhës është ai që e ndërmjetëson procesin dhe konfirmon pranimin. Nëse nuk ka përgjigje brenda një periudhe të caktuar, vizita konsiderohet e miratuar.

Marrëveshja për vizitat zyrtare parashikon, gjithashtu, që

secila palë të caktojë një zyrtar, i cili do të ketë qasje të rregullt dhe të thjeshtuar te pala tjetër dhe tek i cili palët do të ofrojnë informacione logjistike për ta lehtësuar përgatitjen e vizitave.

Disa nga vizitat e parealizuar

Disa herë në vit njëra palë ose tjetra informon publikun se një vizitë zyrtare nuk është miratuar. Gjatë vitit të kaluar Bashkimi Evropian reagoi në disa raste për ndalimin e vizitave, duke i bërë thirrje si Kosovës ashtu edhe Serbisë t'u përmbahen marrëveshjeve të arritura. Për shembull, në fillim të vitit 2024 Beogradi zyrtar ia ndaloi ministrit të Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, ta vizitojë Luginën e Preshevës në Serbinë jugore, ku jeton popullata shumicë shqiptare.

Bashkimi Evropian më pas njoftoi se vizita e ministrit Sveçla ishte paralajmëruar në përputhje me marrëveshjen për vizitat zyrtare dhe i bëri thirrje Beogradit ta lejojë atë. Më pas,

në maj të vitit 2024, Kosova ia ndaloi vizitën drejtorit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković. Disa ditë më vonë është ndaluar edhe vizita e patriarkut serb, Porfirije, me shpjegimin e autoriteteve të Kosovës se vizitat nga Serbia nuk do të lejohen derisa Beogradi zyrtar vazhdon t'i shkelë marrëveshjet e Brukselit dhe të mos e ndalojë fushatën kundër Kosovës në skenën ndërkombëtare. BE-ja ka reaguar sërish, duke thënë se me ndalimin e vizitës së patriarkut serb, Kosova ka shkelur marrëveshjen e arritur me Serbinë në kuadër të dialogut. Por, ndërkohë, palët kanë lejuar edhe disa vizita të ndërsjella të zyrtarëve. Kështu, shqiptarët në Serbi janë vizituar nga zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, dhe ministria e Jashtme, Donika Gërvalla, ndërsa presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, dhe tashmë ish-kryeministria serbe, Ana Bërnabiq, kanë vizituar verin e Kosovës.

Dialogu në nivel të lartë politik në mes të Kosovës dhe Serbisë

është bllokuar prej se një grup i armatosur serbësh sulmoi Policinë e Kosovës në fshatin Banjskë të Zveçanit, në shtator të vitit 2023, dhe vrau një polic. Këtij sulmi i paraprinë tensione të larta, pasi serbët në pjesën veriore braktisën institucionet e Kosovës, për ta kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për zëvendësimin e targave serbe me ato të Kosovës.

Serbët lokalë ngritën barrikada e bënë protesta, si dhe i bojkotuan zgjedhjet lokale. Ky veprim rezultoi me ardhjen e kryetarëve shqiptarë në krye të katër komunave me shumicë serbe. I dërguari i ri i BE-së për dialogun, Peter Sorensen, vizitoi Prishtinën dhe Beogradin këtë muaj, dhe tha se prioritet i tij është të sigurojë një takim ndërmjet përfaqësuesve të Kosovës dhe Serbisë.

Shefja e politikës së jashtme të BE-së, Kaja Kallas, ka deklaruar në shkurt se i ka marrë parasysh kritikën për formatin aktual të dialogut Kosovë - Serbi dhe se ajo, së bashku me Sorensenin, do t'i shqyrtojnë opsionet për ta bërë atë funksional.

Begaj: Shpresojmë në mbështetjen e Sllovakisë për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare

TIRANË, 28 MARS - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, e ka pritur të premten homologun nga Sllovakia, Peter Pellegrini. Begaj në një konferencë të përbashkët për medie ka bërë me dije se në takimin kokë me kokë kanë biseduar edhe për Kosovën, duke shpresuar se Sllovakia do ta mbështesë Kosovën në anëtarësimin në aktorët ndërkombëtarë.

Sllovakia është një nga pesë shtetet e Bashkimit Evropian (BE) që ende nuk e ka njohur Kosovën. "Një temë tjetër e bisedimit tonë kishte të bënte me Kosovën. Shqipëria vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në promovimin e stabilitetit rajonal, dhe e mbështet pazezervë rrugëtimin e shtetit të ri, Kosovës. Për ne Kosova është një demokraci e

qëndrueshme dhe një faktor stabiliteti i rëndësishëm. E falënderova z. Pellegrini që Sllovakia e ka njohur pasaportën e Kosovës nga viti 2012. Shqipëria shpreson në mbështetjen e Sllovakisë për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, për mundësinë e rishikimit të qëndrimit me Republikën e Kosovës", ka thënë Begaj.





HAMZA: JAM I GATSHËM TA MARR PËRGJEGJËSINË PËR KRIJIMIN E QEVERISË SË RE

Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, pas certifikimit të zgjedhjeve të 9 shkurtit nga KQZ-ja, ka thënë se është i gatshëm ta formojë qeverinë re nëse një gjë të tillë dështon ta bëjë Vetëvendosja. Hamza ka thënë se Kosova nuk e ka komoditetin të ketë vakum institucional. Ai ka përsëritur qëndrimin e edhe gjatë fushatës zgjedhore se nuk ka vija të kuqe për asnjë parti dhe është i gatshëm të bisedojë me të gjithë. Pavarësisht prej kësaj, Hamza ka thënë se qeverinë është i gatshëm ta bëjë me partitë e deritashme opozitare me përfaqësuesit e të cilave ka bërë me dije se është në komunikim

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

PRISHTINË, 28 MARS - Kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka thënë të premtën se është i gatshëm ta formojë qeverinë nëse partia e parë nuk arrin t'i krijojë institucionet. Hamza në një konferencë për medie ka theksuar se Kosova nuk e ka komoditetin të ketë vakum institucional. "Bazuar në situatën gjeopolitike dhe ekonomike në të cilën ndodhet vendi, Kosova ka nevojë për institucione. Në rast se partia e parë nuk arrin brenda afateve ligjore dhe kushtetuese, unë jam i gatshëm si kandidat për kryeministër nga Partia Demokratike e Kosovës t'i marrë përgjegjësitë për krijimin e

qeverisë. Jam në komunikim me partitë opozitare, që ne ta krijojmë qeverinë dhe t'ia japim institucionet vendit", është shprehur Hamza. Hamza ka njoftuar se është tërhequr nga mandati i deputetit. "Unë, duke respektuar Kushtetutën dhe ligjet, dje kam hequr dorë nga pozita e të qenit deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sepse unë jam kryetar i komunës së Mitrovicës. Komuna do të shkonte në zgjedhje. Do të ishte e padrejtë që brenda një periudhë të shkurtër, ndoshta më pak se 6 muaj, komuna të shkojë dy herë në zgjedhje. Do të ishte pengesë për zhvillimin e projekteve, por edhe barrë për buxhetin e Republikës së Kosovës dhe maltretim i qytetarëve të Mitrovicës", ka thënë ai. Hamza ka shprehur

shqetësimin për stërzgjatjen e shpalljes dhe certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 9 shkurtit. Më tutje, Hamza ka përsëritur qëndrimin edhe gjatë fushatës zgjedhore, se nuk ka vija të kuqe për asnjë parti dhe është i gatshëm të bisedojë me të gjithë. Megjithatë, ai ka thënë se deri më tani ka biseduar me partitë që gjendeshin në opozitë. "Sa iu përket takimeve, me disa parti politike thuajse jemi në rregull. Mund të vijmë tek ajo faza, te pjesa ku mund të flasim për formulën për përbërjen e qeverisë. Ndërsa sa iu përket disa partive politike, në këtë rast me Lidhjen Demokratike të Kosovës, ende nuk kemi arritur në atë fazë që ta diskutojmë formulën e krijimit të qeverisë. Mirëpo, unë jam shumë i hapur për

diskutime", ka thënë Hamza. Partia e tretë, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka vendosur si kusht marrjen e postit të kryeministrit për çdo marrëveshje eventuale për një koalicion të ardhshëm qeveritar. Hamza është pyetur nëse PDK-ja është e gatshme të pranojë këtë kusht. Ai ka thënë se deri më tani nuk i është prezantuar një kusht i tillë. "Renditja është e qartë, PDK-ja është e dyta, i ka 24 deputetë, dhe asnjëherë në tavolinë nuk kemi pasur kërkesë, apo temë se si do të duket qeveria e re. Radha dihet dhe mbi bazë të kësaj ne do të diskutojmë", ka thënë Hamza. Pavarësisht se ka thënë se nuk ka vija të kuqe për asnjë parti, Hamza është shprehur se pëlqen të krijojë një ekzekutiv ku nuk do të ishte LV-ja. "Me partinë e parë, LV-në, nuk kemi deri në këtë moment kurrfarë komunikimi zyrtar. Nuk kemi pranuar ftesë, nuk kemi bërë ftesë, sepse ftesa dhe radha dihet si shkon. Realisht, për shkak të programeve, bindjeve politike dhe koncepteve, gjithmonë e kam thënë që për mua është e pëlqyeshme krijimi i qeverisë me LDK-në dhe partitë e tjera që kanë ulëse në Kuvendin e Kosovës", ka thënë ai. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar të enjten

rezultatit zgjedhor, duke i hapur rrugë formimit të institucioneve të reja. Por, në bazë të rezultateve, asnjëra parti nuk mund ta formojë e vetme qeverinë, andaj kërkohen që të krijohen koalicionet. Sipas ligjeve, fillimisht duhet të konstituohet përbërja e re parlamentare, duke u zgjedhur kryetari dhe nënkryetarët. Propozimi për kryetarin e ri të Kuvendit i takon partisë së parë, në këtë rast LV-së. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, fillimisht duhet ta mandatojë LV-në për formimin e qeverisë. E nëse LV-ja dështon ta sigurojë mbështetjen e 61 deputetëve, atëherë presidentja Osmani është e obliguar që brenda dhjetë ditësh t'i ftojë në konsultime partitë politike. Pas konsultimeve, është në diskrecionin e saj për të vendosur për mandatarin e ri, nëse ai dëshmon se i ka numrat për ta formuar ekzekutivin. Sipas rezultateve, LV-ja ka fituar 48 ulëse, PDK-ja 24, LDK-ja 20, AAK-Nisma 8 dhe Lista Serbe 9. LV-ja ka thënë se ajo do të udhëheqë qeverinë e re, dhe nga kjo parti kanë thënë se pëlqejnë të bashkëpunojnë me partitë pakicë - joserbe. Partitë joserbe kanë dhjetë ulëse të garantuara në Kuvendin e Kosovës, ndërkaq komuniteti serb ka dhjetë ulëse të tjera.

KOSOVËS I SHTOHEN EDHE 344 USHTARË TË RINJ

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 MARS - Të premten është mbajtur ceremonia e certifikimit të 344 rekrutëve të rinj të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Në këtë ceremoni kanë marrë pjesë liderët e institucioneve të vendit dhe familjarët e rekrutëve të rinj. Në fjalën e saj, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se rruga e Kosovës drejt integritimeve euroatlantike është e qartë dhe e pakthyeshme, duke theksuar se Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) çdo ditë po dëshmon se është e denjë për të qenë pjesë e strukturave



ndërkombëtare të sigurisë dhe të mbrojtjes. E para e shtetit ka thënë se këta ushtarë të rinj po bëhen pjesë e një force që çdo ditë po zhvillohet e po bëhet ushtri moderne e profesionale, “e gatshme për t’u përballur me çdo sfidë”. “FSK-ja po marshon fuqishëm përpara në procesin e avancimit si forcë moderne, e mirëpajisur dhe e mirëtrajnuar. Ushtria jonë çdo ditë e më shumë po dëshmon gatishmërinë e plotë për të

përmbushur standardet më të larta të NATO-s, aty ku Kosova e ka vendin dhe e meriton vendin”, ka thënë Osmani. Sipas saj, FSK-ja – që është në proces të transformimit në ushtri – është një aleate e besueshme e partnerëve ndërkombëtarë dhe është garanci për paqe dhe siguri për Kosovën.

Ndërsa kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se gjatë mandatit katërvjeçar qeveritar janë rekrutuar 2 315 ushtarë të rinj. Sipas tij, në muajt në vijim atyre do t’u shtohen edhe 3 90 ushtarë, duke bërë që numri total i rekrutimeve të reja të arrijë në 2 705 ushtarë. “Ju jeni garancia më e fuqishme që



dronëve Bayraktarë nga Turqia, sistemet kundërtanke “Javelin” nga Shtetet e Bashkuara, dhe duke përsëritur se Kosova shpejt do të ketë në inventar edhe helikopterët amerikanë “Black Hawk”.

Po ashtu, Kurti ka thënë se buxheti për ushtrinë është rritur gjatë katër vjetëve të fundit. “Synimi ynë është i qartë - ndërtimi dhe rritja e një ushtrie që respekton standardet më të larta të NATO-s dhe që është pjesë aktive e arkitekturës së sigurisë ndërkombëtare demokratike. Kosova nuk është një shtet që kërkon vetëm mbështetje, Kosova është një partnere që kontribuon, që

investon dhe që garanton sigurinë rajonale”, ka thënë Kurti. Së fundi, Kosova ka iniciuar hapjen e një fabrike për prodhimin e municioneve brenda vendit, por edhe të dronëve. Përveç industrisë së mbrojtjes, institucionet kanë ndërmarrë hapa në thellimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë me Shtetet e Bashkuara, por edhe me shtete të tjera rajonale, që janë pjesë e NATO-s, sikurse Kroacia dhe Shqipëria. Thellimi i bashkëpunimit në mbrojtje vjen në kohën kur po vazhdon procesi i transformimit të FSK-së në ushtri, proces që pritet të përmbyllet më 2028. Ministria e



Mbrojtjes ka konfirmuar më herët për Radion Evropë e Lirë se numri i pjesëtarëve të FSK-së ka kaluar 4 300 dhe se vitin e ardhshëm pritet të arrijë në mbi 5 000. Kosova mëton që një ditë të bëhet pjesë e strukturave të aleancës ushtarake perëndimore të NATO-s, por ka pengesa në këtë drejtim, pasi në aleancë janë katër shtete që ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

Haradinaj: Është urgjencë dyfishimi i pagave në sektorin e sigurisë në Kosovë

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka kërkuar dyfishim të pagave për sektorin e sigurisë në Kosovë. Duke komentuar certifikimin e 344 rekrutëve të rinj të FSK-së, ai ka vlerësuar se paga e dinjitetshme e ushtarit, policit dhe e zyrtarëve që punojnë në inteligjencë është obligim qeveritar e kombëtar. Haradinaj ka lavdëruar ushtrinë e Kosovës duke thënë se ajo është ndërtuar sipas standardeve të NATO-s. “Sot Kosova ka ushtrinë më të re, sipas modelit të NATO-s, të përkushtuar për sigurinë në vend, stabilitetin në rajon dhe të gatshme për operacione paqeruajtëse kudo në botë, si anëtare e NATO-s përkrah Amerikës dhe aleatëve tjerë strategjikë. Është urgjencë që të dyfishohen pagat për të gjithë sektorin e sigurisë në Kosovë, sidomos në këto rrethana mbi të cilat gjendet sektori i sigurisë në rajon e me gjerë. Paga e dinjitetshme e ushtarit, policit, inteligjencës e më gjerë është obligim qeveritar e kombëtar. Urime dhe shumë suksese në këtë mision fisnik!”, ka thënë Haradinaj.

PRESIDENTJA THOTË SE SHPEJT DO TË CAKTOHET SEANCA KONSTITUIVE E KUVENDIT TË KOSOVËS

PRISHTINË, 28 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se shumë shpejt do të caktohet edhe data se kur do të mbahet seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës.

Osmani, gjatë një prononcimi për gazetarë më 28 mars, ka thënë se Presidenca ka pranuar shkresën zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), pasi një ditë më parë u certifikuan rezultatet zgjedhore për votimet e 9 shkurtit. Ajo ka thënë se do ta respektojë afatin ligjor që brenda 30 ditësh të thirret seanca konstituive. “Për momentin, ekipi im ligjor është duke e analizuar se sa mund të ketë nevojë për kohë për përgatitje të kësaj seance, në



mënyrë që kur të thirret seanca, edhe të jetë e suksesshme, pra të jetë i suksesshëm konstituimi i Kuvendit. Gjithçka do të bëhet brenda

afatit kushtetues. Për momentin nuk mund t’ju jap një datë, sepse dua të jem e saktë, por shumë shpejt do ta keni edhe datën”, ka thënë

Osmani.

Pas certifikimit të zgjedhjeve hapi i parë drejt formimit të institucioneve të reja është mbajtja e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës.

Gjatë kësaj seance zgjidhen kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit, dhe deputetët e rinj bëjnë betimin. Propozimi për kryetarin e ri i takon partisë së parë në zgjedhje, në këtë rast Lëvizjes Vetëvendosje.

Ndërkaq, partitë më të mëdha politike propozojnë nga një kandidat për nënkryetar, por edhe deputetët e komunitetit serb dhe ata të komuniteteve joshumicë duhet të propozojnë nga një deputet për postin e nënkryetarit.

Kryetari dhe nënkryetarët

zgjidhen me shumicë të votave. Seanca konstituive, sipas Rregullores së Kuvendit, përfundon me zgjedhjen e tyre. “Ndërprerjet gjatë seancës konstituive nuk mund të jenë më të gjata se 48 orë”, thuhet në Nenin 12, pika 5 e Rregullores së Kuvendit. Vetëm pasi të ketë përfunduar seanca konstituive, presidentja mund të vazhdojë me obligimet ligjore për ta mandatuar partinë e parë për formimin e qeverisë së re. Megjithatë, është në diskrecionin e saj që të mandatojë më pas parti të tjera për ta formuar ekzekutivin, nëse partia e parë nuk arrin ta marrë mbështetjen e 61 deputetëve në Kuvend për qeverinë e re.

NGUSHËLLIMI PËRMES SYVE

Shkruan: Ismail SYLA

Mos fol! Mos pëshpërit! Mos bëj shenja me gisht! Mos mbaj shishe uji, etj.! Mos mbaj çantë! Këto janë simbolet e ndalesave, të ngjitura në pjesën e poshtme të ekraneve - monitorë në galerinë e ndërtesës së Gjykatës Speciale në Hagë. “Mos u afroni përpara” është vëtejtja e shkruar në tri gjuhë, shqip, anglisht dhe serbisht (mos u përkulni) pikërisht poshtë xhameve të blinduar, përmes të cilëve mund të ndiqen seancat gjyqësore, që si shprehje kanë nuanca dallimi nga gjuha në gjuhë. Po u përkthye nga anglishtja fjalë për fjalë, i bie seancë dëgjimore, nga serbishtja shkundje kryesore, ndërsa shqip seancë gjyqësore. Në këtë galeri përmes kufjeve mund të dëgjosh zhvillimet e seancës në tri gjuhë. Në shqip dëgjohen zërat e përkthyesve që nga mënyra si shqiptohen fjalët, lehtë identifikohen se janë nga Shqipëria. Ka ndodhur në të kaluarën që këta përkthyes të shkaktojnë ngatërtime qesharake. Bie fjala, kur një dëshmitar shqiptar tha se me vetura kemi lëvizur në terun (në kohë kur toka ka qenë jo e lagshtë, pra e tertë, e tharë, pa baltë, pa lloç, pa llucë), përkthyesja ia “futi” në terr, pra në errësirë. Sapo e dëgjoi këtë fjalë prokurorja, ia mësyu pyetjeve për arsyet pse bash në terr, errësirë keni lëvizur, duke hapur një kapitull të ri misterioziteti të lëvizjes së njerëzve të UÇK-së. Dëshmitari nuk qe në gjendje ta kuptojë ngatërresën dhe të sqarojë se nuk tha “terr”, por “terun”, pra në tokë, rrugë jo të lagur nga shiu, a shkrirja e borës. Në fillim të kësaj jave, edhe gjatë paradites, por edhe pasdite, i përcolla seancat nga galeria e kësaj gjykate. Ngritja në këmbë, me rastin e hyrjes së trupit gjyqësor është e detyrueshme edhe për vizitorët në pjesën e galerisë, e po ashtu edhe sa herë që dalin gjykatësit nga seanca. Sapo ngrihen në këmbë gjykatësit, fillon rënia automatike e perdes dhe



mbyllet dukja në sallë. Vizitorët mund të lëvizin një kat më poshtë, në hapësirën përdhese, gjatë pauzës 10-minutëshe, ose të dalin jashtë ndërtesës, në pauzën gjysmë orëshe, ose atë një orë e gjysmë të drekës. Për ata që rrinë tërë ditën në galeri, e vërejnë që ajri i kondicionuar është i pamjaftueshëm, se rraskapitja dhe gjumi të ndjekin pa një pa dy. A bëhet kjo qëllimshëm a është defekt teknik, nuk dihet. Kur një punëtoreset të sigurimit ia shfaq këtë ndjenjë, ajo me mirësjellje thotë se do t'ia transmetojë këtë përgjegjësit të saj. Punëtorët e sigurimit ndërrohen shpesh. Nuk hezitojnë për tërheqje vërejtjeje për ndonjë veprim të vizitorëve, galeristëve: që të mos diskutojnë, të mos nënqeshin ose për ndonjë shenjë drejtuar të personave që po gjykohen.

Gjatë kohës kur hyjnë gjykatësit në sallë, edhe të pandehurit ngrihen në këmbë dhe me atë rast drejtojnë sytë drejt galerisë, gjë që nuk është shkelje. Derisa nga pozicioni ulur në ulëset e galerisë tërë kohën mund të shihen presidenti Thaçi dhe Rexhep Selimi si dhe anëtarët e trupit mbrojtës, nga ky pozicion nuk shihen Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, as ekipet mbrojtëse të tyre, sepse xhami i blinduar është i mjegulluar, opak. Ata mund të shihen vetëm nëse afroresh tek xhami, gjë që nuk “lejohet” edhe nga fjalët në shirit “Mos u afroni përpara”. Z. Veseli dhe z. Krasniqi mund të shihen vetëm kur të ngriheni në këmbë, nëse jeni i ulur në rendin e karrigeve afër xhamit. Që nga bastisja më 1 nëntor 2023, nuk e kam vizituar më asnjëherë presidentin Thaçi. As nuk i lejohet thirrja përmes

telefonit. Ai më 13 mars të këtij viti erdhi në QKUK për ta vizituar babain e sëmurë rëndë. Ishte një vizitë që bëri bujë. Ata qytetarë që qëlluan atë kohë në oborrin para klinikës interne treguan qytetari dhe emancipim të lartë. Thirrën emrin e Thaçit dhe të UÇK-së. Asnjë thirrje kundër ekipit të Hagës, kundër EULEX-it. Madje, një qytetar tha se ne këtu shprehim përkrahje për presidentin dhe UÇK-në. Ne nuk ndërmarrim asnjë hap të gabuar. Vizita e presidentit Thaçi la gjurmë mediale. La përshëndetjen me dorë në zemër dhe atë të gishtit të madh, fitues, gishtin e OK-ejit, gishtin mbretëror të shpëtimit, faljes së gladiatorit. Gjatë kësaj vizite nuk bëra “turr” në QKUK, me të vetmin motiv, të mos bie në sy, jo nga frika, por nga një kod i respektimit të njeriut që

kishte ardhur ta takojë prindin në gjendje të rënduar shëndetësore. Nuk vonoi dhe babai i presidentit vdiq. Më 21 mars, ditën e parë të pranverës, tri ditë pas varrosjes, presidenti Thaçi vuri një kurorë mbi varrin e babait. Në atë ditë u hap një varr i ri për një nga kushëritë e tij. Pikërisht në atë kohë kur Thaçi përfundoi nderimin te varri i babait, kushërinjtë që qëlluan afër i thonë të mbahet i fortë. Ai, si përgjigje, bëri një gjest, një shenjë. E ngriti dorën e bërë grusht. Ishte grusht i një marifeti të veçantë. Jo grusht proletar, jo grusht i bashkimit kombëtar, jo grusht i unifikimit politik. Ishte shenjë: - Po, jam i fortë! (Kështu, së paku unë e lexova këtë shenjë). Duke qenë se numrit voluminoz të dëshmitarëve të Prokurorisë po u vjen fundi, unë vendosa të bëj shumë kilometra udhë, për ta parë nga afër presidentin Thaçi. Të hënën më 24 mars, në orën 9 u hap seanca e gjykimit. I përshëndeta të gjithë burrat që po gjykohen aty, pa shenjë dore, pa fjalë, vetëm me sy dhe buzëqeshje. I pari më vërejtë Rexhep Selimi. Përmes xhamit të blinduar i shpreha ngushëllime presidentit Hashim Thaçi, as me dorë, as me fjalë, por vetëm me sy. Kjo shprehje ngushëllimi është më e veçantja nga të gjitha ngushëllimet që kisha shprehur në jetë. Të burgosurit në Hagë, po i humbin të dashurit e tyre. Kadri Veseli i vdiqën të dy prindërit gjersa po mbahet në burgun e Hagës. Jakup Krasniqi i vdiq një vëlla shumë më i ri në moshë se ai. Z. Gucati i vdiq babai. Nasimit vëllai. Këtyre njerëzve që kanë humbur shokë edhe në kohë lufte, po u vdesin të afërm në kohë burgu. Para një viti vdiq Xhavit Ferizi, njëri ndër bashkëpunëtorët më besnikë të Hashim Thaçit. Të gjitha këto vdekje po marrin një peshë të shtuar. Atë të burgut. Vdekja e babait të presidentit qoftë e fundit, që ata e pritën prapa grilave.

Osmani pranon letrat kredenciale të ambasadorit të ri të Bullgarisë në Kosovë

PRISHTINË, 28 MARS - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pranuar të premtën letrat kredenciale të ambasadorit të ri të Bullgarisë në Kosovë, Hristo Kraevski. Presidentja Osmani e ka uruar ambasadorin Kraevski për detyrën e re dhe ka shprehur mirënjohje të thellë për mbështetjen e vazhdueshme të Bullgarisë dhënë Kosovës, veçanërisht për fuqizimin e sovranitetit, integritetit territorial dhe integritetit euroatlantik të

vendit tonë. Në këtë takim presidentja Osmani e ka falënderuar Bullgarinë për mbështetjen e palëkundur në proceset integruuese të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe ka inkurajuar vazhdimin e avokimit bullgar për fuqizimin e pozitës së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Presidentja Osmani, në takim me ambasadorin e ri të Bullgarisë, ka shtruar nevojën për heqjen e menjëhershme të

masave të padrejta të BE-së, të cilat po i dëmtojnë qytetarët e Kosovës. Në këtë kuadër, presidentja Osmani ka vlerësuar angazhimin e Bullgarisë për sigurinë rajonale dhe globale si dhe angazhimin e homologut të saj, presidentit bullgar Rumen Radev, që ta mbështesë vazhdimisht Kosovën në këtë drejtim. Presidentja Osmani dhe ambasadori Kraevski kanë diskutuar edhe për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit në ekonomi, arsim, kulturë, turizëm e fusha të tjera.



PËRKUJTOHEN 147 CIVILËT SHQIPTARË TË VRARË NGA FORCAT SERBE NË IZBICË



SKENDERAJ, 28 MARS - Komuna e Skenderajt ka përkujtuar masakrën e Izbicës, në të cilën forcat serbe gjatë luftës kishin vrarë e masakruar 147 civilë shqiptarë. Në 26-vjetorin e kësaj masakre

janë bërë nderime nga zyrtarë komunalë dhe përfaqësues të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së. Nënkrjetari i Skenderajt, Sami Lushtaku, ka vlerësuar se ky ishte një krim i rëndë ndaj

popullatës civile. “Në nderim dhe përkujtim të 147 viktimave të Masakrës së Izbicës në 26 vjetorin e rënies, ku forcat serbe ekzekutuan barbarisht burra, gra e pleq të pafajshëm. Ky krim i rëndë i kryer ndaj popullatës

civile me 28 mars 1999 në Izbicë është plagë e thellë që nuk shërohet dhe dëshmi e qartë e gjenocidit serb mbi popullin shqiptar të Kosovës. Lavdi e përgjeshme për viktimat e Masakrës së Izbicës dhe të

gjithë martirët e lirisë”, ka shkruar Lushtaku në “Facebook”. Martirët e Izbicës janë përkujtuar edhe nga presidentja Vjosa Osmani, PDK-ja, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj etj.

BERAT LAHU DHE EDMOND AZEMI PËRJASHTOHEN NGA VETËVENDOSJA



PRISHTINË, 28 MARS - Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë ka njoftuar se asamblistët Berat Lahu dhe Edmond Azemi nuk janë më pjesë e kësaj partie. Sipas njoftimit të LV-së, Lahu dhe Azemi janë nga kjo parti me vendim të komisionit disiplinor, i cili është marrë më 10 mars. “Dy anëtarë të grupit parlamentar të Kuvendit Komunal në Prishtinë janë përjashtuar nga Lëvizja Vetëvendosje, Berat Lahu dhe Edmond Azemi nuk janë më pjesë e Lëvizjes Vetëvendosje!, me vendim të komisionit disiplinor të Lëvizjes. Vendimi i parë është marrë me datën

10.03.2025. Votimi dhe prezenca në seanca në të cilat dëmtohet interesi publik dhe tjetërsimi i vullnetit të qytetarëve për interesa të ngushta, janë arsytet e këtij përjashtimi. Rruga jonë është gjatë dhe vështirë, ata që për interesa personale tjetërsojnë këtë rrugëtim nuk kanë vend në Lëvizje!”, është thënë në njoftimin e LV-së. Pas përjashtimit nga Vetëvendosja, ka reaguar Berat Lahu, i cili do të jetë asamblist i pavarur në Kuvendin Komunal të Prishtinës. Lahu e ka akuzuar Arben Vitinë se në vitin 2021 i ka humbur qëllimshëm zgjedhjet për kryetar të Prishtinës ndaj Përparim Ramës.

Shkëmb Manaj i LDK-së emërohet nënkryetar i Prishtinës

PRISHTINË, 28 MARS - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar se ish-kandidatin për deputet të LDK-së, Shkëmb Manaj, e ka emëruar nënkryetar të kryeqytetit. I pari i Prishtinës ka lavdëruar nënkryetarin e ri, duke thënë se është njeri me vlera të larta. Rama ka shkruar në “Facebook” se Manaj në të gjitha etapat jetësore e ka ruajtur integritetin. “Shkëmb Manaj nga sot është nënkryetar i kryeqytetit. Me një

përkushtim të thellë për të mirën e qytetarëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të kryeqytetit, ai është një model i dedikimit në çdo hap të jetës së tij profesionale. Në të gjitha etapat e karrierës së tij, Shkëmb Manaj ka ruajtur integritetin e tij të palëkundur. Vlerat e tij familjare dhe kombëtare janë thelbësore në çdo vendim që merr, duke përfaqësuar me dinjitet dhe përkushtim qytetarët e vendit të tij. Ai vazhdon t'i

përfaqësojë unitetin, bashkëpunimin dhe solidaritetin si themele të një shoqërie të zhvilluar dhe të qëndrueshme. Me punën e tij të deritanishme, ai ka ndihmuar në zhvillimin e një shoqërie ku secili ndihet i respektuar dhe i vlerësuar. Jam i sigurt se do të vazhdojë të kontribuojë dhe të përfaqësojë këto vlera edhe si nënkryetar i kryeqytetit, duke punuar për një të ardhme më të mirë dhe më të ndritur për qytetarët”, ka shkruar Rama.



Pastrimi i parave dëmton buxhetin e shtetit, minon sistemin ekonomik

PRISHTINË, 28 MARS - Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Hulumtuese (BIRN Kosova) ka publikuar dokumentarin mbi pastrimin e parave me elemente ndërkufitare. Ky dokumentar hedh dritë mbi praktikat dhe rrjetet ndërkufitare të pastrimit të parave si dhe ofron një perspektivë të thelluar mbi rolin e institucioneve dhe gazetarëve hulumtues në luftën kundër këtij fenomeni. Ministria në detyrë e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është një betejë e rëndësishme për stabilitetin dhe të ardhmen e vendit. Ajo ka përmendur edhe sfidat që paraqet mosanëtarësimi i Kosovës në Interpol dhe në Këshillin e Evropës, duke shtruar nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar. “Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nuk është vetëm një çështje e drejtësisë, por është edhe një betejë për sigurinë dhe stabilitetin, por edhe për të ardhmen tonë. Pajtoheni që korrupsioni

dëmton themelet e një shteti, pengon zhvillimin ekonomik dhe minon besimin e qytetarëve në institucionet publike. Ndërsa krimi i organizuar e përdor korrupsionin si një mekanizëm për t’i pastruar paratë e përfituara nga veprimtaritë e paligjshme dhe për t’i forcuar rrjetet kriminale që nuk njohin kufij shtetërorë. Prandaj, Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë hapa të guximshëm për të luftuar këtë fenomen, duke e bërë drejtësinë prioritet. Në vitin 2024 kemi realizuar një numër rekord të ekstradimeve të individëve që përfshihen në krim të organizuar dhe krimet financiare. Nga Kosova janë ekstraduar 32 të dyshuar në vendet partnere, ndërsa 45 të tjerë janë sjellë që të përballen me drejtësinë në Kosovë. Mes tyre ka pasur individë që drejtonin rrjete kriminale të trafikut të drogës dhe grupe të përfshira në krim të organizuar. Sfidë mbetet mosanëtarësimi ynë në Interpol dhe Këshill të Evropës që kufizon kapacitetet tona për ndjekjen dhe arrestimin ndërkombëtar të kriminelëve. Por, pavarësisht



prej këtyre pengesave, Kosova ka ndërtuar ura bashkëpunimi me këto”, ka thënë ministria Haxhiu. Ndërsa ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, e ka cilësuar pastrimin e parave si një dukuri që dëmton buxhetin e shtetit dhe minon sistemin ekonomik. “Pastrimi i parave është një prej dukurive që do të na përcjellë çdo ditë e më shumë. Ne kemi

aprovuar t’i zbatojmë të gjitha standardet ndërkombëtare për luftimin e pastrimit të parave, duke përfshirë edhe parandalimin e kësaj dukurie. Jemi ndër vendet më të suksesshme në raportet e Këshillit të Evropës për parandalim dhe luftim të kësaj dukurie. Ne kemi identifikuar dhe po identifikojmë çdo ditë njerëz nga fusha të ndryshme, biznese të ndryshme nga ato

legale dhe ilegale që lakmojnë për të pastruar para për përfitime të ndryshme. Më vjen mirë që Prokuroria Speciale ka pasur prioritet parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie, duke përfshirë tani me Ligjin e ri Prokurorinë Speciale dhe Prokurorinë Themelore që janë kompetente për këto vepra”, ka thënë Kelmendi. Kurse Kreshnik Gashi nga BIRN Kosova ka theksuar rëndësinë e ndryshimit të mentalitetit rajonal rreth pastrimit të parave dhe ndikimin e tij negativ në shoqëri. “Kur jemi ulur me ekspertët e ambasadës britanike të zhvillojmë idenë qëllimi i krejt kësaj pune ka qenë ndryshimi i mentalitetit ballkanik, i cili e sheh shpëlarjen e parasë si mundësi për ta zhvilluar vendin, ekonominë, arsimin, shëndetësinë dhe krejt jetën publike dhe politike të vendit tonë. Dëshmitë tona, dokumentimi ynë tregojnë që tolerimi i shpëlarjes së parave në krejt rajonin e Ballkanit në asnjë rast nuk është një storie suksesi, nuk ka sjell zhvillim, nuk ka sjell demokraci. Shpëlarja e parave na ka sjellë vetëm varfëri”, ka thënë Gashi.

Kompanitë eksportuese gjermane, para kohësh të vështira

BERLIN, 28 MARS - Më shumë se gjysma e kompanive gjermane që janë aktive jashtë vendit po përballen kohën e fundit me barriera tregtare shtesë. Sipas rezultateve të një sondazhi të Dhomës së Tregtisë dhe të Industrisë të Gjermanisë (DIHK), më shumë se gjysmës së kompanive gjermane që kryejnë aktivitet jashtë vendit u është dashur kohën e fundit të përballen me barriera tregtare shtesë. Kërkesat për sigurinë dhe sanksionet janë vetëm dy nga shumë çështje që ua vështirësojnë edhe më tepër punën eksportuesve gjermanë.

Shqetësim sidomos lidhur me ShBA-në

Drejtori i Drejtorisë për Tregtinë e Jashtme në DIHK, Volker Treier, ka tërhequr vëmendjen për zhvillimet në ShBA-në nën



drejtimin e presidentit Donald Trump. “Pengesat tregtare në rritje dhe sinjalet proteksioniste nga Uashingtoni po shkaktojnë shqetësim të madh për

kompanitë tona”, ka thënë ai. Presidenti Trump ka nxitur mosmarrëveshje tregtare si me BE-në, edhe me Kinën dhe fqinjë të ShBA-së, Kanadanë

dhe Meksikën. 70 për qind e kompanive gjermane që morën pjesë në anketë thanë se prej politikës tregtare të ShBA-së prisnin

efekte negative ndaj biznesit të tyre. Vitin e kaluar ShBA-ja ishte fener shprese për firmat gjermane. Tani situata është përkeqësuar sidomos për kompanitë gjermane që kanë biznese në ShBA.

Pritet rënie e eksporteve

Sondazhi është kryer përpara se Trumpi të shpallte planet për të vendosur tarifa shtesë prej 25 për qind për importet e makinave. Dhoma Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë tani ka frikë se bizneset e eksportuesve gjermanë do të shkojnë edhe më keq dhe se do të ketë rënie të eksporteve. Rënia e eksporteve pritet madje që për vitin 2025, ka thënë drejtori i Drejtorisë për Tregtinë e Jashtme në DIHK, Volker Treier./DW

ZRrE-ja: Nuk është marrë ende vendimi për shtrenjtimin e rrymës

PRISHTINË, 28 MARS - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) ka sqaruar opinionin publik se nuk është marrë asnjë vendim për rritjen e tarifave të energjisë elektrike. Në kuadër të transparencës dhe përfshirjes së palëve të interesuara, ZRrE-ja ka njoftuar se ka publikuar për konsultim raportin konsultativ për të

hyrat e lejuara maksimale. ZRrE-ja treguar se konsumatorët, organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset kanë pasur kohë që deri të premten t’i shprehin komentet e tyre lidhur me këtë çështje. “Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) dëshiron të sqarojë opinionin publik se aktualisht nuk është marrë

asnjë vendim për rritjen e tarifave të energjisë. Me qëllim që të sigurohet transparencë dhe të krijohet mundësia e një dialogu të hapur nga të gjitha palët e interesuara, ZRrE-ja ka vendosur të ndajë për konsultim publik Raportin konsultativ për të hyrat e lejuara maksimale”, ka njoftuar ZRrE-ja.



PËRTEJ DYERVE TË VDEKJES

A është përvoja pranë vdekjes një dritare drejt botës tjetër, apo thjesht kimia e fundit e trurit?

Dr. Christian JARRETT

Ata lënë pas trupin, shohin një dritë të fortë dhe kthehen të ndryshuar përgjithmonë. Por a janë përvojat pranë vdekjes (NDEs) një vështrim i shkurtër drejt përjetësisë? Kërkimet e fundit në momentet e fundit të funksionimit të trurit mund të ndihmojnë në zbërthimin e këtyre vizioneve enigmatike midis jetës dhe vdekjes. Nuk do ta harroj kurrë ditën kur neuropsikiatri Dr. Peter Fenwick vizitoi klasën tonë të psikologjisë në vitet 1990. Elegant dhe i qartë në shprehje, me një theks autoritar dhe termat neuroanatomikë që rridhnin natyrshëm prej tij, ai na fliste për përvojat pranë vdekjes. Fillimisht skeptik, Fenwick u shpreh se tashmë kishte prova të forta që shumë njerëz afër vdekjes kujtonin se kishin parë veten nga lart, apo madje kishin parë ngjarje që ndodhnin në pjesë të tjera të spitalit – gjë që nuk do të kishte qenë e mundur nëse ndërgjegjja e tyre nuk do të ishte shkëputur nga trupi fizik. Që atëherë, kërkimi mbi përvojat pranë vdekjes është zgjeruar shumë. Një studim i fundit zbuloi se 15% e pacientëve në kujdes intensiv kishin përjetuar një përvojë pranë vdekjes (PPV). Por këto përvoja nuk janë të reja – studiuesi Gregory Shushan ka mbledhur dëshmi për to nga kultura dhe kohë të ndryshme, që nga Kina e shekullit VII p.e.s. deri në Ganën e shekullit XIX. Edhe Hieronymus Bosch, në pikturën e tij të shekullit XVI “Ngjitja e të Bekuarve”, paraqet një imazh të përvojës pranë vdekjes. Në shekullin XIX, gjeologu zviceran Albert von St Gallen Heim grumbulloi rrëfime nga alpinistët që kishin shpëtuar për mrekulli, ndërsa në vitin 1975, psikologu amerikan Raymond Moody e bëri temën të njohur me librin “Life After Life”. Edhe pse Fenwick fillimisht e quajti atë “psikologji e lehtë”, takimet me persona që kishin përjetuar PPV ia ndryshuan qëndrimin.

Rrëfime që sfidojnë shkencën

Sot, ekzistojnë mijëra rrëfime të ngjashme nga njerëz që i kanë mbijetuar vdekjes klinike. Leanda Pringle nga Connecticut tregon se gjatë një infeksioni të rëndë të veshkave, përjetoi ndjesinë se po fluturonte mbi trupin e saj dhe ndjeu një prani që e mbushi me lumturi të thellë. “Ishte një ndjenjë që nuk e kisha provuar kurrë më parë. E pamundur për t’u përshkruar me fjalë,” thotë ajo. Ndërsa Tommy McDowell, një veteran i ushtrisë nga Teksasi, përjetoi një përvojë të ngjashme gjatë shtatë ditëve në respirator. Ai përshkruan ndjesinë e një “pranie transformuese paqeje, dashurie dhe qetësie absolute”,

dhe ndjeu si të gjitha traumat dhe pendesat po zhdukeshin prej tij. “Ishte e shenjtë, ishte Zoti,” thotë ai.

Shkenca e vdekjes: çfarë ndodh në tru?

Shkencëtarët kanë identifikuar disa elementë të përbashkët në përvojat pranë vdekjes: përjetimi jashtë trupit, drita e fortë, kalimi në një tunel, rishikimi i jetës dhe ndjesia e thellë e paqes. Por shumë neurologë mendojnë se këto përvoja nuk lidhen me botën shpirtërore, por me proceset e fundit që ndodhin në trurin që po shuhet. Një studim novator nga Universiteti i Michiganit vitin e kaluar zbuloi se dy pacientë, pak pasi iu hoq mbështetja jetike, përjetuan një rritje të papritur të aktivitetit të trurit në zonat që lidhen me ndërgjegjen – një fenomen i vëzhguar më parë vetëm tek minjtë. Aktiviteti u shënua në frekuencat gamma, të lidhura me përpunimin e vetëdijes, dhe pati lidhje të shtuar me korteksin prefrontal – qendra e vendimmarrjes dhe vetëdijes. “Ky studim sugjeron fuqishëm se truri i njeriut, në momentet e fundit të jetës, mund të aktivizohet në mënyrë të pazakontë,” shkruajnë autorët.

Kimia e fundit e trurit

Studime mbi kafshët kanë treguar se gjatë mungesës së oksigjenit, truri çliron sasi të mëdha të neuro-transmetuesve si dopamina, serotonina dhe glutamati – të njëjtat kimikate që ndikojnë në gjendjen emocionale dhe ëndrrat. Një studim tregoi se serotonina në trurin e një miu rritej deri në 20 herë më shumë se norma brenda pak minutash nga asfiksia. Për këtë arsye, disa studiues besojnë se përvojat pranë vdekjes janë pasojë e një vale të madhe kimike që shkakton ndjesitë intensive të paqes, largimit nga trupi dhe dashurisë absolute që shumë dëshmojnë.

Ndikimi i substancave halucinogjene

Një tjetër pistë kërkimi janë eksperimentet me substanca si LSD, psilocibina (përbërësi aktiv i kërpudhave halucinogjene) dhe DMT – e njohur si “molekula e shpirtit”. Përdoruesit e këtyre substancave kanë raportuar përvoja të ngjashme me PPV, si ndjesia e shkëputjes nga trupi dhe e komunikimit me një fuqi më të lartë. Dr. Charlotte Martial, neuropsikologe nga Universiteti i Liezhit, ishte pjesë e një studimi ndërkombëtar që krahasoi përvojat e njerëzve nën ndikimin e DMT-së me ata që kishin përjetuar vërtet një PPV. Ngjashmëritë ishin të habitshme. “Mund të supozohet



që disa molekula të prodhuara natyrshëm nga trupi të imitojnë efektet e DMT ose ketaminës gjatë situatave të rrezikshme për jetën,” thotë ajo.

Dëshmi për diçka... më shumë?

Këto janë zhvillime emocionuese, por shumë nga ekspertët që merren me përvojat pranë vdekjes mbeten të pakënaqur me shpjegimet thjesht neurobiologjike. Deri në ndarjen e tij nga jeta në nëntor të vitit 2024, Dr. Peter Fenwick vazhdoi të ishte i bindur se pas PPV-ve fshihej diçka më e thellë. Për të, rrëfimet e këtyre përvojave përbëjnë dëshmi se shpirti njerëzor ekziston përtej trurit. Në të njëjtën linjë është edhe profesorja në pension Janice Holden nga Universiteti i North Texas – aktualisht presidente e Shoqatës Ndërkombëtare për Studimet mbi Përvojat Pranë Vdekjes. Ajo shpreh dyshime serioze mbi shpjegimet e bazuara në kimikatet e trurit, duke thënë se rritjet e serotoninës apo neurotransmetuesve të tjerë janë një qasje tepër e thjeshtuar për të shpjeguar përvoja kaq të thella. “Sasi të vogla, të përkohshme dhe të kufizuara të aktivitetit të trurit – edhe nëse do të vërtetohej që ndodhin rregullisht në lidhje me përvojat pranë vdekjes, gjë që ende nuk ka ndodhur – nuk mund të shpjegojnë përpunimin kompleks të vetëdijes që ndodh gjatë tyre,” thotë ajo. Ajo shton se një shpërthim i neurotransmetuesve nuk mund të shpjegojë atë që në literaturë njihet si “perceptime të verifikuara” – për shembull, raste kur një person që po vdes pretendon se ka parë ngjarje që ndodhnin në një vend tjetër. “Si mund ta shpjegojë një valë e shkurtër gamma në tru raportimin e saktë të një amputimi në këmbë që ndodhte në sallën ngjitur të operacionit?” – pyet ajo, duke iu referuar një rasti të dokumentuar nga

anestezisti francez Dr. Jean Jacques Charbonier. Nga ana e tyre, neuroshkencëtarët pranojnë se këto perceptime ende nuk janë provuar në mënyrë përfundimtare. “Megjithatë, hipoteza e një ndërgjegjeje jo-lokale mbetet një mundësi reale,” pranon Dr. Charlotte Martial. “Dhe është një mundësi që aktualisht po e testojmë në një prej studimeve tona të vazhdueshme në spital.” Për Janice Holden dhe shumë të tjerë që punojnë në këtë fushë, një nga aspektet më të rëndësishme të kërkimit lidhet me pasojat psikologjike për ata që kanë kaluar përmes një përvoje pranë vdekjes. Studimet tregojnë se këta persona mbeten me kujtime jashtëzakonisht të gjalla dhe të thella, dhe shumë prej tyre raportojnë ndryshime të mëdha në mënyrën si e shohin jetën dhe vdekjen.

Sipas Holden, këto pasoja ndahen në disa kategori:

- Psikologjike: përfshijnë humbjen e frikës nga vdekja, largimin nga materializmi dhe rritjen e ndjeshmërisë ndaj të tjerëve dhe mjedisit;
- Shpirtërore: një interes i shtuar ndaj temave shpirtërore;
- Fizike: ndryshime në metabolizëm, oreks, nevojë për gjumë dhe ndjeshmëri ndaj medikamenteve dhe stimuljeve si drita dhe zhurmat;
- Shoqërore: personat e martuar që kanë përjetuar PPV kanë një prirje më të lartë për divorc, ndryshim të rrethit shoqëror, lidhjeve me organizata apo edhe profesionit, për t’iu përshtatur ndryshimeve të reja të brendshme.


Për shkak të ndikimit të thellë emocional, disa ekspertë të shëndetit mendor argumentojnë se duhet ofruar mbështetje e strukturuar psikologjike për pacientët e kujdesit intensiv që kalojnë përmes PPV. Në vitin 2021, këshilltarja shpirtërore dhe e shëndetit mendor Lilia Samoilo dhe Dr. Diane Corcoran (ish-presidente e Shoqatës Ndërkombëtare për

Studimet mbi Përvojat Pranë Vdekjes) ngritën alarmin për atë që e quajtën “boshllëk mjekësor në përkujdesjen ndaj pacientëve me PPV”. Sipas tyre, rrëfimet e këtyre përvojave shpeshherë neglizhohen, nuk besohen, ose keqinterpretohen si probleme mendore.

“Nëse pacientëve nuk u ofrohet edukim mbi përvojat pranë vdekjes, ata mbeten me pyetje pa përgjigje dhe ngecin në një limbo emocionale,” shkruajnë ato. Kjo bëhet edhe më urgjente kur merret parasysh që një pjesë e konsiderueshme e PPV-ve janë emocionalisht shqetësuese – përfshirë ndjesi të tmerrshme, vizione ferri apo përjetimin e asgjësimit.

Një dritare e re: realiteti virtual

Edhe pse nuk është e mundur të provokohet me qëllim një PPV, një mënyrë interesante që studiuesit po përdorin për të eksploruar ndikimet psikologjike të tyre është realiteti virtual. Në një studim nga Universiteti i Barcelonës, 16 pjesëmarrës përjetuan një “vdekje virtuale” në një ishull të simuluar – përfshirë ndjesinë e daljes nga trupi, një rishikim të jetës dhe një udhëtim drejt një drite. Krahasuar me një grup kontrolli, këta pjesëmarrës shfaqën më shumë sakrifica vetiake dhe interes për çështje globale sesa materiale. Një studim tjetër nga i njëjti ekip tregoi se përvoja virtuale e daljes nga trupi çoi në ulje të frikës ndaj vdekjes. Studiuesit e përshkruajnë këtë si “një shembull ekstrem të një përvoje transformuese”. Ndërsa kërkimet për përvojat pranë vdekjes vazhdojnë, ato ngrejnë pyetje intriguese për shkencëtarët dhe filozofët. Në një nga intervistat e tij të fundit para vdekjes në vitin 2024, Peter Fenwick u shpreh i gëzuar që gjithnjë e më shumë njerëz po ndihen të lirë të flasin për përvojat e tyre transcendete pranë vdekjes. Kjo rritje e hapjes ndaj PPV-ve do të ndihmojë punën e neuroshkencëtarëve që përpiqen të kuptojnë çfarë ndodh me trurin në ato çaste vendimtare. Por ndërsa debati për shpjegimin thjesht biologjik mbetet i hapur, ajo që nuk vihet në dyshim është fuqia emocionale dhe transformuese që kanë këto përvoja për ata që i kanë jetuar. “Pas asaj përvoje pranë vdekjes, jeta ime nuk do të jetë më kurrë e njëjtë,” thotë Leanda Pringle. “Edhe pse më mori shumë kohë ta përvetësoja plotësisht, aftësitë që kam tani më duken si diçka nga një film fantastiko-shkencor. Besoj sinqerisht se kam sjellë një pjesë të atij realiteti me vete.” Dr. Christian Jarrett – neuroshkencëtar kognitiv dhe autor i disa librave për trurin dhe ndërgjegjen. / ScienceFocus – Në shqip nga bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit



Kurti uron Vëllaznimin për titullin kampion në Ligën Unike

PRISHTINË, 28 MARS - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, e ka uruar Klubin e Basketbollit Vëllaznimi për triumfin në Ligën Unike. Ekipi nga Gjakova shënoi fitore në finale 91:88 duke e mposhtur Sigal Prishtinën pas

vazhdimëve. Ky ishte trofeu i parë i Vëllaznimit pas 29 vjetësh. “Vëllaznimi i Gjakovës, kampion i Ligës Unike! Lojë shumë e barabartë dhe dramatike e të dyja skuadrave që nuk u dorëzuan për asnjë moment. Ndeshje që shkoi përtej kohës së rregullt e

që në fund Vëllaznimi triumfoi ndaj Sigal Prishtinës me rezultat 91-88. Urime basketbollistëve, klubit, tifozëve dhe të gjithë Gjakovës. Në edicionin e sivjetshëm të Ligës Unike vendin e tretë e zuri Besëlidhja e Lezhës”, ka shkruar Kurti.

Duele vendimtare në Superligë

“Epoka e re”

MITROVICË, 28 MARS - ProCredit Superliga vazhdon këtë fundjavë me përballje tejet interesante, teksa kampionati po i afrohet fundit të garave të rregullta. Çdo ndeshje tashmë ka peshë të madhe, me skuadrat që luftojnë për pozitën më të mira në tabelë. “Xehëtarët” do t’i presin prizrenasit në “Minatori”, me synimin për ta mbajtur pozitën e dytë. Trepça ka regjistruar 16 fitore dhe 9 humbje, ndërsa Proton Cable është në vendin e fundit me 5 fitore dhe 20 humbje. Një tjetër përballje e madhe do të luhet të shtunën mbrëma, ku Bashkimi përballlet me Golden Eagle Yllin. Therandasit janë në formë të shkëlqyer me katër fitore radhazi, ndërsa Bashkimi hyn në këtë duel me 18 fitore e 7 humbje. Ylli ka një

bilanc prej 12 fitoresh dhe 13 humbjes. Derbi i madh i kësaj jave zhvillohet të dielën, ku Peja pret Sigal Prishtinën në “Karagaqi”. Pejanët kanë 13 fitore dhe 12 humbje, ndërsa prishtinasit ndajnë të njëjtin bilanc me Trepçën 16 fitore dhe 9 humbje. Një përballje që pritet me padurim nga të gjithë. Në “Shani Nushi”, Vëllaznimi synon t’i vazhdojë paraqitjet pozitive kundër Borës. Gjakovarët kanë 12 fitore dhe 13 humbje, ndërsa Bora ka arritur 8 fitore dhe ka pësuar 17 humbje.

ORARI - JAVA 26

Të shtunën takohen:
20:00 Trepça - Proton Cable Prizreni
20:00 Bashkimi - Golden Eagle Ylli

Të dielën takohen:
20:00 Peja - Sigal Prishtina
20:00 Vëllaznimi - Bora



Faqja zyrtare e Serisë A ngre në qiell Rrahmanin



NAPOLI, 28 MARS - Mbrojtësi i Përfaqësueses së Kosovës dhe Napolit, Amir Rrahmani, është lojtari që ka kompletuar më shumë pasime të sakta deri tani këtë sezon. Kapiteni i “dardanëve” është ngritur në qiell nga faqja zyrtare e Serisë A pas statistikës brilante në kompletimin e pasimeve. “Profesor Amir Rrahmani është lojtari me pasimet më të suksesshme në këtë sezon të Serisë A”,

shkruan në faqen zyrtare “Lega Serie A”. Mbrojtësi nga Kosova i Napolit ka arritur këtë sezon të kompletojë me sukses plot 1 889 pasime, duke lënë pas

vetes shumë emra të njohur. Pas Rrahmanit, pozitën e dytë e zë Evan Ndicka i Romës me 1 848 pasime të suksesshme, ndërsa treshja kompletohet me Alessandro Bastonin e Interit që ka kompletuar me sukses 1 619 pasime. Në pozitën katër dhe pesë gjenden dy lojtarët e Juventusit, Pierre Kalulu dhe Manuel Locatelli, të cilët kanë 1 599 pasime të suksesshme, respektivisht 1 577 pasime.

PESE LOJTARËT QË KANË KOMPLETUAR MË SHUMË PASIME NË SERIE A

Amir Rrahmani - 1889 pasime të suksesshme
Evan Ndicka - 1848 pasime të suksesshme
Alessandro Bastoni - 1619 pasime të suksesshme
Pierre Kalulu - 1599 pasime të suksesshme
Manuel Locatelli - 1577 pasime të suksesshme

Arian Azemi, MVP i finales në Ligën Unike

Gjakovë, 28 mars - Arian Azemi tregoi edhe një herë pse është lider i Vëllaznimit, duke dhuruar paraqitje fantastike në finalen e Ligës Unike kundër Sigal Prishtinës. Me 24 pikë, 6 kërcime dhe 3 asistime, ai ishte forca kryesore e

skuadrës gjakovare në këtë fitore të madhe. Përkushtimi dhe shpërthimi i tij në parket bën dallimin në një ndeshje ku duhej lidhë dhe vendosmëri. Azemi mori përgjegjësinë në çastet kyçe dhe udhëhoqi ekipin drejt triumfit, duke u shpallur

lojtari më i mirë i ndeshjes finale. Një performancë që vulos edhe më shumë emrin e tij si një nga basketbollistët më të mirë të këtij edicioni në Final 4 Ligën Unike. Çmimin e MVP-së e dorëzoi drejtor gjeneral i Bankës TEB, Orcun Ozdemir.



McLaren i trembet Ferrarit: Kanë dy pilotë të fortë, janë të vetmit që na kanë mundur këtë sezon

Surrey, 28 mars - McLaren ka dominuar në botërorin 2025 të Formula 1, duke i fituar të dyja garat e zhvilluara deri më tani, në Australi (Norris) dhe Kinë (Piastri). Mes këtyre dy sukseseve një shkëndijë e Ferrari, që fitoi garën sprint në Kinë me Hamiltonin. Gjithsesi, makina italiane ka vetëm 17 pikë dhe në

kampionatin e konstruktorëve është 61 pikë prapa McLaren, lider i renditjes. Edhe pse në Maranello po dyshojnë për besueshmërinë e makinës, te britanikët mendojnë se kjo është e përkohshme. Te McLaren ende i frikësohen Ferrarit, çka konfirmohet në fjalët e drejtorit ekzekutiv Zak

Brown: “Unë dyshoj se Ferrari do të jetë rivali ynë më i vështirë, për shkak të linjës së tyre të pilotëve. Për të qenë i sinqertë, ne i marrim të gjithë seriozisht”. “George Russell po bën një punë fantastike në Mercedes dhe unë mendoj se Kimi Antonelli mund të bëhet më i fortë. Ndërsa te Red Bull janë

duke vuajtur me pilotët dhe ende kanë probleme”, u shpreh Zak Brown. Edhe drejtori i ekipit Andrea Stella, nuk është i qetë: “Gjërat duken mjaft mirë, por avantazhi që kemi është një ose dy të dhjetat për xhiro. Dhe kjo nuk është shumë. Ne duhet të vazhdojmë të përmirësojmë makinën”.



Ramaj konfirmon interesimin nga Kosova, por vazhdon ta presë Gjermaninë

Portieri shqiptar nën pronësi të Borussia Dortmundit, Diant Ramaj, ka konfirmuar interesimin e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) për t’iu bashkuar Kosovës, por interesimi i tij vazhdon të mbetet përfaqësimi i Gjermanisë. I nënshkruar nga Dortmundi dhe i huazuar menjëherë gjatë afatit kalimtar të janarit, Ramaj aktualisht po mbron në veri të Danimarkës te Copenhageni. 23-vjeçari i lindur në Shtutgart, me prejardhje nga Kosova, ka folur për të ardhmen e tij në një intervistë të publikuar në edicionin e shtypur të së mërkurës në “Sport Bild”. Djaloshi me prindër nga Kosova dikur konsiderohej si një nga portierët më perspektivë gjatë kohës së tij me Eintracht Frankfurt, por ftesa nga Kombëtarja e Gjermanisë nuk po vjen, edhe pse Ramaj vazhdon ta pres. “Unë qëndroj në kontakt me ish-trajnerin e portierëve [DFB Junior] Manuel



Schneider. Nuk kam dëgjuar kurrë asgjë nga ekipi senior. Unë ende e di se nëse tregoj aftësitë e mia, do të jetë e vështirë të më mbajnë jashtë radarit”, ka thënë fillimisht Ramaj. “Ndryshimi i madh i gjeneratës [në pozicionin e portierit] nuk është domosdoshmërisht një disavantazh për mua”. Ramaj u pyet gjithashtu për

Kombëtarene e Kosovës, ku konfirmoi interesimin e FFK-së, por jo edhe gatishmërinë për t’iu bashkuar “dardanëve”. “Ka pasur disa kontakte. Jo me mua personalisht, por me disa të njohurit e mi. Interesimi është shumë i fortë, por dua të përpiqem për më të mirën në karrierën time”, ka përfunduar portieri Ramaj.

Indiana vendos rekordin sezonal të pikëve, Oklahoma skuadra e parë që prek 60 fitore

UASHINGTON, 28 MARS - Indiana fitoi me rezultat 162-109 në fushën e Washingtonit, duke u bërë skuadra që ka shënuar më shumë pikë në një ndeshje të vetme këtë sezon. Sfidë ku 9 lojtarë të Indianas realizuan mbi 10 pikë (Haliburton me 29 pikë më i miri) dhe 14



basketbollistë shënuan në koshin e skuadrës vendase. Oklahoma mbetet skuadra më e mirë në NBA, duke qenë e para

që kalon shifrën e 60 fitoreve këtë sezon. Ajo mundi me rezultat 125-104 Memphisin. Alexander Shai me 37 pikë ishte lider. Fiton edhe Clevelandi, skuadra më e mirë në Konferencën e Lindjes, që falë 29 pikëve të Allen mundi me shifrat 124-116 San Antonion. Humbje në sekondën e fundit për lakersat, që u mund me rezultat 19-117 nga Chicago. Një kosh i Giddey (25 pikë, 14 rebounde, 11 asistime) nga mesi i fushës i dha fitoren Bullsit. Fitorja e tretë radhazi për Miamin, që mundi me rezultat 122-112 Atlanta (Tyler Herro 36 pikë), ndërsa Dallasi fitoi me shifrat 101-92 në fushën e Orlandos (Jaden Hardy 22 pikë).

REZULTATET	
Cleveland - San Antonio	124-116
Orlando - Dallas	92-101
Washington - Indiana	109-162
Miami - Atlanta	122-112
Chicago - Lakers	119-117
Oklahoma - Memphis	125-104
Utah Jazz - Houston	110-121
Sacramento - Portland	128-107

SHKURT

Interi synon ta shesë Asllanin për 30 milionë euro

Edhe pse është ende larg, Interi po mendon për merkaton e verës. Përveç afrimeve të mundshme, vëmendje të veçantë meriton edhe merkato në dalje. E ardhmja e Kristjan Asllanit varet nga bilanci i klubit, me Interin që shpreson ta shesë mesfushorin shqiptar për një shifër që shkon rreth 30 milionë euro. Asllani nuk dëshiron të largohet pasi kërkon të kthehet në protagonist me zikaltrit, por një ofertë e mirë mund ta ndryshojë mendjen e futbollistit dhe mund ta bindë Interin. Duke pasur parasysh rivalitetin e madh në mesfushë, Asllani është thirrur në apel vetëm në rastet kur Inzaghi ka pasur mungesa. 23-vjeçari u transferua tek Interi në vitin 2021 nga Empoli. Në këtë sezon ai ka luajtur 16 ndeshje në kampionat, nuk ka provuar ende shijen e golit, ndërsa ka dhuruar dy asistime. Merkato e verës do të tregojë të vërtetën për diamantin kuqezi, i cili mund të ndryshojë mjedis, pasi Interit i duhen para dhe largimi i një futbollisti që nuk është titullar stabil duket zgjidhja e duhur.

Osasuna kërkon fitore në tavolinë ndaj Barcelonës

Barcelona fitoi me rezultatin 3-0 ndaj Osasunës mbrëmjen e së enjtes dhe u ngjit në krye të klasifikimit të La Ligës. Osasuna synon t'i fitojë tri pikë në tavolinë. Bëhet fjalë për aktivizimin e Inigo Martinez nga ekipi katalanas. Ky i fundit u largua nga përfaqësuesja e Spanjës për shkak të dëmtimit dhe në Rregulloren e FIFA-s një lojtar që tërhiqet për shkak të dëmtimit nga kombëtarja nuk mund të luajë me klubin e tij për pesë ditë e ardhshme. Spanja e luajti ndeshjen e fundit më 23 mars. Tani pritet nëse një rast i tillë mund ta sjellë humbjen në tavolinë për Barcelonën.

Alvesi shpallet i pafajshëm për përdhunim

Gjykata e Lartë në Kataluni ka liruar Dani Alvesin nga akuzat për sulm seksual, pasi ai është dënuar pak më shumë se një vit më parë. Incidenti ndodhi në dhjetor të vitit 2022 në një klub nate në Barcelonë, por ish-lojtari i blaugranëve dhe Sevillass është shprehur i pafajshëm që kur u dorëzua në polici në janar të vitit 2023. Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi ankesën e Alvesit pas konfirmimit të dënimit. Sipas gazetës “Sport”, tre gjyqtarët që ishin në këtë çështje gjetën një “seri boshllëqesh, pasaktësisht, mospërputhjesh dhe kontradiktash në fakte, vlerësimin gjyqësor dhe pasojat e tyre”, lexohej në vendimin e gjykatës sot (e premte) në mëngjes. Fillimisht Alvesi u dënua për përdhunim dhe u dënua me 4.5 vjet burg, pas një gjyqi që zgjati disa javë për të përfunduar. U desh më shumë se një vit që çështja të arrinte në gjyq, me Alvesin që kaloi 14 muaj në paraburgim – atij iu mohua lirimi me kusht dhe iu konfiskua pasaporta pasi ai konsiderohej si rrezik i ke. Pas dënimit, Alvesi vendosi një garanci me kusht që thuhet se kapte vlerën e rreth 1 milion euro dhe që atëherë jeton në kryeqytetin katalunas, megjithëse atij i është mohuar leja për t’u larguar nga vendi sa apeli i tij ishte në proces.

Lukaku: Interi është favorit për titull


Barazimi i fundit kundër Venezuelas, mbi të gjitha ecuria jopozitive këtë periudhë, bëri që Napoli të lëshonte kreun, por ekipi i Contes nuk ka ndër mend të dorëzohet. Fundja,

Interi është vetëm tri pikë larg. Dy ditë përpara supersfidës me Milanin, për ta ndezur edhe një herë ambientin në Napoli ka menduar Romelu Lukaku, por bomberi belg

është realist teksa thekson se zikaltrit janë favoritë për ta fituar titullin në Serinë A. “Interi është favorit, ka një grup më të madh dhe lojtarë me cilësi. Duhet të jemi të

sinqertë në këtë pikë, por kur sheh këtë sezon, askush nuk e mendonte se do të vinim në këtë pikë. Tani ne jemi këtu. Nuk na mbetet gjë tjetër vetëm të punojmë më fort për të parë

se deri ku do të arrijmë. Është një ëndërr, por për ta realizuar duhet të shtyjmë më shumë, ditë pas ditë, për të qenë gati në çdo aspekt”, u shpreh Lukaku.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Potera BP” SH.P.K. me seli në Podujevë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811401918 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Potera BP” D.O.O. Podujevë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811401918 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Potera BP” L.L.C. with headquarters Podujevë, has come to the decision to quit its business: 811401918 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qemajl Morina shpall te pavlefshme diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Armend Sadikaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Anita Thaqi shpall te pavlefshme diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Arton Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Abdyl Frasheri” Prizren.

- Enver Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12,13 dhe diplomën e shkollë së mesëm të mjekësisë “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Krijon Shehu shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 të Gjimnazit “Kuvendi i Junikut”, Junik.

- Arben Vehapi shpall te pa vlefshme Diplomën e shkollës se mesme "Ruzhdi Berisha " Dragash.

- Gëzim Jakupi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Dr. Ali Sokoli” Prishtinë.

- Diella Ymeraga nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe testin e maturës të gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Mustafa Haki Deva nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Fisnik Haxhija shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës me nr 1918.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1903

Columbus, Georgia, USA
Since 1903

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

